



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E SHTËRPCËS

---



# STATUTI I KOMUNËS SË SHTËRPCËS

Korrik, 2010

Në bazë të dispozitave të nenit 123 dhe nenit 124 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 12.2 dhe 12.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr: 28 të datës 04.06. 2008, Shtojca 1 e Ligjit për Kufijt Administrativ të Komunave Nr. 03/L-041, Kuvendi i Komunës së Shtërpcës, në mbledhjen e mbajtur më 09/07/ 2010, miratoi:

**STATUTIN**  
**E**  
**KOMUNËS SË SHTRËPCËS**  
**PJESA E PARË**

**KAPITULLI II – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

- 1.1 Komuna e Shtërpcës është njësi bazike e vetëqeverisjes lokale në Kosovë që përbëhet nga zonat vijuese kadastrale:

ZK Brod/Brod  
ZK Biti e Poshtme/Donja Bitinja  
ZK Biti e Epërme/Gornja Bitinja  
ZK Berevc/Berevce  
ZK Berevc1 /Berevce 1  
ZK Gotovushë/Gotovuša  
ZK Drekov/Drajkovc  
ZK Izhancë/Ižance  
ZK Jazhincë/Jažince  
ZK Kashtanevë/Kaştanjevo  
ZK Sevcë/Sevce  
ZK Sushicë/Sušice  
ZK Vërbeshiticë/ Verbeštice  
ZK Shtërpcë/Štrpce  
ZK Viçë/Viča

- 1.2 Komunës së Shtërpcës i takon edhe lagja “Tërshenja” zona e vikendit në ZK Shtërpcë dhe Vërbeshiticë. Kjo lagje është me karakter turistik. Lagja turistike “Tërshenja” nuk ka status të vendbanimit andaj pronarët e objekteve në këtë lagje nuk mund të konsiderohen si banorë të Komunës së Shtërpcës, çka do të thotë se nuk trajtohen si banorë, andaj rregulloret e Kuvendit Komunal nuk kanë të bëjnë me ata, por i nënshtrohen rregulloreve të veçanta të Kuvendit Komunal (mbi legalizimin e objekteve, pagesën e taksave, tatimin në luks, etj). Pronarët e objekteve në këtë lagje mund të jenë si qytetarë të Kosovës ashtu edhe shtetas të huaj.

- 1.3 Statuti i Komunës së Shtërpcës është akti më i lartë juridik i komunës që miratohet nga Kuvendi i Komunës, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.
- 1.4 Ky statut rregullon organizimin e brendshëm dhe funksionimin e komunës, autoritetin e organeve komunale, kompetencat komunale dhe bashkëpunimin e komunës me autoritetet e tjera lokale si dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendim-marrjes në organet komunale.

## **Neni 2**

### **Pajtueshmëria ligjore**

Përgjegjësitë e komunës ushtrohen, organizohen dhe menaxhohen në pajtueshmëri të plotë me ligjet që rregullojnë përgjegjësitë e komunës në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e punës të miratuar nga kuvendi komunal.

## **Neni 3**

- 3.1 Statuti i Komunës zbatohet brenda kufijve të Komunës së Shtërpcës të përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe Ligjit mbi Kufijtë Administrativ të Komunave të Kosovës si dhe nenit 1.1 të këtij Statuti.
- 3.2 Komuna mund të bashkëpunojë me komunat tjera brenda dhe jashtë Kosovës në ushtrimin e përgjegjësisë së saj në pajtim me ligjet e zbatueshme në Kosovë.

## **Neni 4**

### **Statusi i Komunës**

- 4.1 Komuna e ka statusin e personit juridik.
- 4.2 Komuna e ka të drejtën e posedimit dhe administrimit të pronës, mundësinë për të ushtruar padi dhe paditur në gjykatë kompetente, të drejtën për të lidhur kontrata me entitete fizike dhe ligjore dhe të drejtën për të pranuar dhe larguar stafin në pajtim me ligjet e zbatueshme të Kosovës.

## **Neni 5**

### **Selia e Komunës**

Selia e Komunës është në fshatin Shtërpcë.

## **Neni 6**

### **Simboli**

- 6.1 Komuna e Shtërpcës ka simbolet e saj të aprovohen dhe ndryshohen nga kuvendi komunal, në pajtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore të Republikës së Kosovës dhe ato nuk i përngajnë simboleve të shteteve apo komunave të tjera brenda apo jashtë Republikës së Kosovës.
- 6.2 Simboli i komunës është i pranueshëm për të gjitha komunitetet.
- 6.3 Komuna e Shtërpcës shënon për çdo vit Ditën e saj të Komunës. Dita e Komunës është 10 Gushti, dita kur Komuna pas suprimimit në vitin 1965 përsëri është riformuar më (10.08.1988).

- 6.4** Në Ditën e Komunës, Kuvendi i Komunës manifeston synimet e tij për një qytet të hapur, duke u angazhuar për paqe dhe bashkëpunim me komunat brenda dhe jashtë Kosovës.
- 6.5** Simboli i komunës dhe dita e komunës mund të miratohet apo ndryshohet me dy të tretat (2/3) e shumicës së votave të kuvendit komunal pasi që të jenë bërë konsultime publike të gjëra.

## **Neni 7**

### **Vula**

- 7.1** Komuna e Shtërpcës ka një vulë të rrumbullakët dhe një vulë katrore të protokollit që përmbajnë tekstin vijues në gjuhën serbe dhe shqipe:
- 7.2** Vula e rrumbullakët përmban emrin dhe simbolin zyrtar të komunës dhe organin komunal që merr vendimin me shkronja të mëdha të shtypit. Vula e rrumbullakët ka këtë tekst në:
- a) rrethin i parë: Republika e Kosovës,
  - b) në rrethin e dytë: Komuna e Shtërpcës,
  - c) në rrethin e tretë: Kuvendi Komunal, Kryetari i Komunës, Drejtoria e komunës
  - d) në mes të vulës është: emblema.
- 7.3** Vulën e rrumbullakët e mbajnë këto organe:
- a) Kuvendi komunal
  - b) Kryetari i komunës
  - c) Drejtoritë komunale
- 7.4** Vula e protokollit të Komunës ka formën e katërkëndëshit këndëdrejtë me tekstin në vijim:

Republika e Kosovës,  
Komuna e Shtërpcës,  
Rrethi i tretë (është e përshkruar në pikën C)  
Nr. \_\_\_\_data \_\_\_\_\_.

- 7.5** Vulat përdoren për punë zyrtare dhe mënyra e përdorimit të vulës komunale nga organet komunale përcaktohet në një rregullore të posaçme të komunës.
- 7.6** Asnjë entitet apo person tjetër, përveç organeve të autorizuara komunale, nuk mund ta përdorë simbolin dhe vulat komunale.

## **Neni 8**

- 8.1** Kuvendi i Komunës ndan shpërblime, dekorata dhe mirënjohje.
- 8.2** Kuvendi i Komunës me vendim të veçantë përcakton kriteret dhe mënyrën e ndarjes së shpërblimeve, të dekoratave dhe mirënjohjeve.
- 8.3** Dhënia e shpërblimit ose mirënjohja në të holla ose në vlerë të të hollave nuk duhet të

tejkalojë vlerën prej 100-€, përveç në rast se Kuvendi i Komunës merr vendim për një shumë më të lartë.

## Neni 9

**9.1** Gjuhët zyrtare në komunën e Shtërpçës janë gjuha Serbe dhe Shqipe.

**9.2** Kuvendi komunal miraton një rregullore të posaçme për përdorimin e gjuhëve në administratën komunale dhe në institucionet e komunës.

# PJESA E DYTË

## KAPITULLI I - II -

### PËRGJEGJËSITË DHE KOMPETENCAT E KOMUNËS

## Neni 10

**10.1** Komuna brenda territorit të vet ka pushtet të plotë ekskluziv dhe është përgjegjëse për sa i përket interesit lokal, duke respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm për fushat si në vijim:

- a) zhvillimin lokal ekonomik;
- b) planifikimin urban dhe rural;
- c) shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;
- d) zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;
- e) mbrojtjen e mjedisit lokal;
- f) ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike lokale dhe të infrastrukturës: furnizimin me ujë, ujësjellësin dhe kanalizimin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, mirëmbajtjen e rrugëve lokale, transportin lokal dhe skemën e ngrohjes lokale;
- g) përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale;
- h) ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukativo-arsimore, punësimin, pagesën e pagave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit;
- i) promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- j) ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor;
- k) ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale siç është: përkujdesa për të cenueshmit, strehimin familjar, përkujdesni fëmijëror, përkujdesni për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale;
- l) banimin publik;
- m) shëndetësinë publike
- n) licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me: argëtimin, aktivitetet kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, shitësit në rrugë,

transportin publik lokal dhe taksitë, gjuetinë dhe peshkimin, restaurantet, motelet, hotelet e tjera;

- o) emërtimin dhe riemërtimin e rrugicave, rrugëve dhe vendeve tjera publike;
- p) ofrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave dhe parqeve publike;
- q) turizmin;
- r) aktivitetet kulturore dhe të lira dhe
- s) çështjet tjera që nuk janë përjashtuar shprehimisht nga kompetencat e komunës apo nuk i janë caktuar një autoriteti tjetër.

## 10.2 Komuna e Shtërpcës ka kompetenca të zgjeruara në këto fusha:

- a) Ofrimin e shëndetësisë sekondare, duke përfshirë licencimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor, rekrutimin, pagesën e pagave dhe trajnimin e personelit të kujdesit shëndetësor dhe administratorëve;
- b) Autoritetin për të ushtruar përgjegjësi në çështjet kulturore, përfshirë mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe fetare Serbe dhe të tjera brenda territorit të komunës, si dhe përkrahjen e komuniteteve lokale fetare, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi; dhe
- c) Të drejta të zgjeruara për pjesëmarrje në emërimin e komandantëve të stacionit policor siç përcaktohet në Ligjin mbi Policinë.

## 10.3 Komuna gjithashtu është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve në fuqi që kanë të bëjnë me kompetencat që i delegohen asaj nga pushteti qendror lidhur me zbatimin e këtyre ligjeve:

- a) regjistrat kadastral,
- b) regjistrat civil,
- c) regjistrin e votuesve,
- d) regjistrimin e biznesit dhe licencimin, distribuimin e pagesave të ndihmës sociale (jo edhe pensioneve)
- e) mbrojtja e pyjeve që ndodhen në territorin e komunës në kuadër të autorizimeve të deleguara nga autoriteti qendrorë, duke përfshirë dhënien e licencave për prerjen e drunjve në bazë të rregullave të miratuara nga qeveria.

## Neni 11

### Organizatave jofitimprurëse

Komuna e Shtërpcës përkrah aktivitetin e organizatave jofitimprurëse, duke përfshirë edhe organizatat jofitimprurëse të komuniteteve, aktiviteti i të cilave është në kuadër të ofrimit të shërbimeve. Të gjitha këto organizata i përmbahen ligjit në fuqi gjatë ofrimit të shërbimeve dhe zhvillimit të aktiviteteve.

## PJESA III

### KAPITULLI I -III- FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE

#### Neni 12

- 12.1 Për të siguruar plotësimin e të gjitha nevojave të qytetarëve dhe ushtrimin e përgjegjësi nga autoritetet lokale sa më afër qytetarëve, Komuna përmes Kuvendit të Komunës vendos të bëjë aranzhime me fshatrat vendbanime dhe lagjet urbane brenda territorit të saj.
- 12.2 Çdo fshat ka udhëheqësin e fshatit i cili zgjidhet në pajtim me rregullat e përcaktuara në rregulloren komunale për zgjedhjet në fshat. Udhëheqësi i fshatit është personi kryesor që kontakton me organet komunale. Udhëheqësi i fshatit mbledh propozimet përmes konsultimeve me anëtarët e fshatit për punët dhe aktivitetet e komunës të ndërlidhura me fshatin e tyre.
- 12.3 Kuvendi komunal mund të bartë përgjegjësi të caktuara fshatrave dhe organeve të tyre dhe t'u ofrojë mjete atyre organeve, më përpjesëtim me përgjegjësitë dhe aktivitetet e bartura.

#### Neni 13

- 13.1 Për shtrirjen edhe më tej të përgjegjësi të përcaktuara me Ligj, Komuna mund të krijojë Zyre Informuese të Komunës apo edhe Zyrë të Shërbimit për t'u ofruar shërbime më afër qytetarëve të saj.
- 13.2 Komuna mban kontrollin e plotë të secilës fushë të kompetencës së vet të dekoncentruar.
- 13.3 Zyrat komunale krijohen në kuadër të Komunës dhe do të funksionojnë në secilën pjesë të saj. Zyrat komunale do të vendosen në Štrpce-Shtërpçë dhe në Drajkovac-Drekoc.
- 13.4 Zyra komunale e Shtërpçës u shërben këtyre fshatrave: Štrpce/Shtërpçe, Donja Bitinja/Biti e Poshtme, Gornja Bitinja/Biti e Epërme, Berevce/Berevc, Brezovica/Brezovicë, Jažince /Jažincë, Sevce/Sevcë, Sušice/Sušicë, Verbeštice/Vërbeshticë. Zyra komunale në Drakovc/Drekoc u shërben këtyre fshatrave: Drajkovac/Drekoc, Brod/Brdo, Firaja/Firajë, Gotovuša/Gotovushë, Izance/Izhancë, Vića/Viçë, Kaštanjevo/Kashtanevë.

#### Neni 14

- 14.1 Zyrat e Komunës do t'i kryejnë detyrat të cilat do të përcaktohen me Rregullore të veçantë të Kuvendit të Komunës.
- 14.2 Zyrat e Komunës përbëhen nga pjesa administrative dhe drejtohen nga stafi i cili është pjesë përbërëse e administratës komunale dhe emërohet nga Komuna. Për ushtrimin e detyrave të saj Zyra e Komunës duhet t'i ketë fondet e nevojshme nga Komuna.

## **PJESA E PESTË**

### **KONSULTIMET DHE PJEËMARRJA E PUBLIKUT**

#### **KAPITULLI I - V -**

#### **KONSULTIMET ME PUBLIKUN**

##### **Neni 15**

- 15.1** Komuna duhet të konsultojë publikun në mënyrë që të sigurojë që vendimet e marra janë të bazuara fuqishëm në fakte, dhe që janë marrë parasysh pikëpamjet dhe përvojat e qytetarëve si dhe që janë përdorë mundësitë e reja dhe kreative para marrjes së vendimit, si dhe që të gjitha vendimet e propozuara mund të zbatohen në mënyrë efektive në praktikë.
- 15.2** Komuna gjithashtu duhet të përkujdeset që qytetarët të kenë pasur mundësi ta shprehin mendimin e tyre dhe se interesat dhe kërkesat e tyre të merren parasysh.

##### **Neni 16**

Komuna mund të shfrytëzojë secilën nga format e konsultimit, të shënuara më poshtë, dhe atë:

- a) fushata informative dhe të publicitetit për promovimin e programeve dhe të aktiviteteve komunale;
- b) kontaktet me grupet e fokusit, për t'i testuar dhe diskutuar politikat;
- c) anketa që kanë të bëjnë me implementimin e politikës;
- d) shpalljet publike të propozimeve lidhur me politikën apo Projekt-Rregulloret, duke ftuar pjesëmarrjen me prezantime;
- e) kontakte të rëndësishme me grupet përkatëse të interesit;
- f) takime publike;
- g) dëgjimet publike dhe
- h) studime për vlerësimin e ndikimit;

##### **Neni 17**

- 17.1** Kuvendi komunal, komitetet e tij dhe kryetari i komunës do të kenë autoritetin që të mbajnë konsulta publike për çdo çështje që është në kompetencat e tyre.
- 17.2** Në secilin rast duhet të jepet një arsytim për mbajtjen e konsultave me publikun. Mënyra e cila shfrytëzohet për mbajtjen e konsultave me publikun, duhet të publikohet 14 ditë përpara dhe duhet t'i lejohet kohë e duhur për përgatitjen e prezantimeve. Rezultatet e konsultimeve duhet të merren parasysh dhe duhet të bëhen publike para se të merret vendimi.

##### **Neni 18**

- 18.1** Të gjitha komunikimet në lidhje me konsultimet duhet të jenë të qarta, dhe duhet të përfshijnë të gjitha informatat e nevojshme për t'i lehtësuar përgjigjet.



- 18.2** Një dokument konsultues duhet të përfshijë një përmbledhje të çështjeve dhe të pyetjeve kryesore për të cilat janë kërkuar mendimet e tyre në mënyrë që të jetë më lehtë për lexuesit të përgjigjen, të kontaktojnë apo të ankohen.
- 18.3** Kur përcaktohen grupet e fokusit në procesin e konsultimit, komuna duhet të përkujdeset që palët relevante të kenë mundësi t'i shprehin mendimet e tyre.

### **Neni 19**

- 19.1** Komuna duhet të sigurojë njoftime të aktiviteteve të saj dhe të miratojë mekanizma të komunikimit në mënyrë që të përmbushen interesat e qytetarëve.
- 19.2** Komuna duhet të vendosë njoftime (shpallje) për informim të publikut dhe t'i shfrytëzojë ato për të shpallur informacione zyrtare rreth aktiviteteve komunale, rreth vendimeve, mbledhjeve publike, vendet e lira te punes në komunë dhe çështje të tjera komunale në interes të publikut të përgjithshëm.
- 19.3** Pa përjashtuar mjetet tjera të komunikimit, konsultat e hapura për publikun duhet të publikohen në webfaqen zyrtare të Komunës.

### **Neni 20**

- 20.1** Komuna duhet të ofroj kohë të mjaftueshme për shqyrtimin e përgjigjeve dhe informacioneve me shkrim. Komuna duhet t'i ofroj së paku 8 javë dhe më së shumti 12 javë për dhënien e përgjigjeve me shkrim për konsultimin e publikut.
- 20.2** Përgjigjet duhet të analizohen dhe rezultatet duhet të bëhen publike, duke iu kushtuar rëndësi mendimeve të shprehura në marrjen përfundimtare të vendimit. Rezultatet e konsultave të hapura me publikun duhet të vendosen në webfaqen zyrtare të Komunës.

## **KAPITULLI I - II – TAKIMET ME PUBLIKUN**

### **Neni 21**

- 21.1** Takimet duhet të mbahen në një sallë që është e mjaftueshme për pjesëmarrjen e publikut të interesuar. Komuna duhet t'i mbajë së paku 2 takime me publikun çdo vit, një në gjashtëmujorin e parë dhe tjetrin në gjashtëmujorin e dytë.
- 21.2** Përveç kësaj, takimet tjera me publikun mund të mbahen edhe në interval tjetër kohor, por gjithmonë duke marrë parasysh intervalin kohor dymujor ndërmjet dy takimeve.

### **Neni 22**

- 22.1** Vendi, data dhe koha e mbajtjes së takimit publik duhet të shpallen së paku dy javë para mbajtjes së takimit. Takimet publike nuk duhet të mbahen në kohë të papërshtatshme për pjesëmarrjen e komuniteteve të veçanta.
- 22.2** Takimet me publikun duhet të jenë të hapura për media.

### **Neni 23**

- 23.1** Kryetari i Komunës apo përfaqësuesi i tij/saj, duhet ta kryesojë mbledhjen me publikun. Ai/ajo duhet ta ketë autoritetin që të përcaktojë procedurën e cila do të zbatohet gjatë mbledhjes si dhe të mos lejojë diskutimin për çështje të cilat nuk janë të parapara për debat.
- 23.2** Ai/ajo mund të vendosë të mos dëgjojë folësit-diskutuesit të cilët prezantojnë pikëpamje të njëjta apo i përsërisin ato dhe mund të përcaktojnë një limit kohor për kohën të cilën e kanë në dispozicion diskutuesit.
- 23.3** Nëse bëhet ndonjë pyetje në takim, e që nuk mund të ketë përgjigje gjatë takimit, pyetësi mund të kërkojë përgjigje me shkrim në një periudhë prej 30 ditësh, pas ditës së takimit.
- 23.4** Procesverbal i secilit takim publik duhet të mbahet me të gjitha informatat e hollësishme që jepen për komunën, me të gjitha propozimet e bëra nga diskutuesit si dhe përgjigjet që janë dhënë në pyetjet e bëra. Një kopje e të gjitha përgjigjeve të dhëna me shkrim, në ndonjë datë të mëvonshme, duhet t'i bashkëngjiten procesverbalit të takimit.

### **Neni 24**

Komiteti për Politikë dhe Financa duhet ta shqyrtojë procesverbalin e mbledhjes publike brenda 60 ditëve pas mbledhjes. Komiteti për Politikë dhe Financa duhet të shqyrtojë secilin propozim të dhënë gjatë mbledhjes dhe pas kryerjes së konsultimeve të nevojshme të bëjë rekomandimet e duhura në takimin e ardhshëm të Kuvendit të Komunës.

### **Neni 25**

#### **Referendumi Lokal**

Qytetarët mund të kërkojnë që rregullat e miratuara nga ana e Kuvendit të komunës t`i nënshtrohen referendumit në qoftë se një kërkesë e tillë nënshkruhet nga 10% e votuesve të regjistruar në komunë. Detajet rregullohen me një rregullore komunale.

### **Neni 26**

#### **Iniciativa Qytetare**

Qytetarët mund të kërkojnë që kuvendi komunal të miratojë, ndryshojë, shfuqizojë rregulloret komunale të cilat bien në kompetencat e komunës nëse iniciativa nënshkruhet nga 15% e votuesve të regjistruar të komunës. Detajet rregullohen me një rregullore të posaçme.

### **Neni 27**

#### **Largimi i kryetarit**

**27.1** Qytetarët e komunës së Shtërpcës mund të marrin iniciativë për largimin e kryetarit, nëse kërkesa mbështetet (përmes nënshkrimeve) nga, së paku njëzet (20%) e votueseve të

regjistruar. Kërkesa e tillë duhet t'i dorëzohet kryesuesit të kuvendit komunal i cili e përcjell çështjen tek institucioni përkatës për administrim të votimit.

**27.2** Nëse shumica e votueseve të regjistruar votojnë për largimin e kryetarit, zgjedhjet e reja për kryetar duhet të mbahen në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet Lokale.

## **Neni 28** **Peticionet**

**28.1** Çdo person apo organizatë që ka interes në komunë ka të drejtë të dorëzojë peticion në kuvendin komunal për çdo çështje që ka të bëjë me punën e komunës. Peticioni është kërkesë për kuvendin komunal për të adresuar çështje specifike apo për të miratuar një rregullore , apo vendime të caktuara dhe kjo përbën një të drejtë elementare demokratike.

**28.2** Kuvendi i komunës duhet të njohë rëndësinë e peticionit dhe t`u përgjigjet të gjitha pyetjeve dhe kërkesave në peticion. Peticioni mund të rezultojë gjithashtu me mbajtjen e takimit publik në të cilin popullata diskuton për çështjet me interes për ta, bashkë me zyrtaret komunal.

**28.3** Të gjitha peticionet mund t`i drejtohen Kuvendit të Komunës, Kryetarit të komunës, Kryesuesit të kuvendit, komiteteve të kuvendit apo drejtorive komunale, drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet postës elektronike.

**28.4** Kuvendi i komunës nuk do të ketë parasysh asnjë peticion që bie jashtë përgjegjësisë dhe kompetencave të komunës.

**28.5** Çdo peticion duhet të përmbajë emrin dhe adresën e organizatorit(ëve) dhe emrat dhe adresat e personave që e nënshkruajnë. Lënda e peticionit duhet të shënohet qartë në çdo faqe të peticionit.

## **Neni 29**

**29.1** Kryetari i komunës në bashkëveprim me kryesuesin e kuvendit të komunës , do ta paraqesë çdo peticion para Kuvendit të komunës brenda 6 javëve nga dita që ai /ajo e pranon peticionin.

**29.2** Kuvendi i komunës mund t`ia referojë peticionin komitetit përkatës për shqyrtim të mëtejshëm. Organizatorët (ët) i/e peticionit do të kenë të drejtë t`i drejtohet pjesëmarrësve të çdo mbledhjeje ku shqyrtohet peticioni.

## **Neni 30**

Kuvendi i komunës do ta merr vendimin përfundimtar lidhur me lëndën e peticionit më së largu 3 muaj pasi të bëhet prezantimi i peticionit në Kuvendin e komunës. Vendimi do të arsyetohet dhe do të kumtohet bashkë me arsyetim.

## KAPITULLI I - III –

### KOMITETET KËSHILLDHËNËSE

#### Neni 31

**31.1** Kuvendi i Komunës do të krijojë këto Komitete Këshillëdhënëse:

- a) Komitetin për Zhvillim Ekonomik;
- b) Komitetin për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- c) Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
- d) Komitetin për Përgjigje Emergjente Lokale
- e) Komitetin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport

**31.2** Këto komitete do të mundësojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendim-marrjes. Me rastin e emërimit të anëtarëve të këtyre komiteteve këshillëdhënëse, Kuvendi i Komunës duhet të sigurojë një përfaqësim të gjerë nga sektorë të ndryshëm të shoqërisë, në krijimin e këtyre komiteteve gjithashtu duhet të merret parasysh edhe barazia gjinore si dhe ato të reflektojnë interesat e komuniteteve ekzistuese.

#### Neni 32

- 32.1** Komitetet Këshillëdhënëse duhet të paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve të Komunës.
- 32.2** Komitetet Këshillëdhënës mund të bëjnë propozime për përmirësimin apo zgjidhjen e problemeve të identifikuara.
- 32.3** Komitetet Këshillëdhënëse për kryerjen e detyrave duhet të punojnë së bashku me Komitetet e Kuvendit në mënyrë të tillë që vendimet e Komiteteve të Kuvendit apo të Kuvendit të Komunës, të merren vetëm pas konsultimit më Komitetin Këshillëdhënës sektorial.

#### Neni 33

Anëtarët e Komiteteve Këshillëdhënës duhet të emërohen me mandat trevjeçar në baza të rregullta, ku 1/3 e anëtarëve duhet të emërohet çdo vit. Asnjë anëtar i Komitetit Këshillëdhënës nuk mund të shërbejë më shumë se në dy mandate të njëpasnjëshme.

## **PJESA E GJASHTË**

### **KUVENDI I KOMUNËS, KRYESUESI DHE ZËVENDËSKRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS**

#### **KAPITULLI I -VI- FUNKSIONET E KUVENDIT TË KOMUNËS**

##### **Neni 34**

Funksionet e Kuvendit të Komunës janë:

- a) Miratimi, ndryshimi dhe shfuqizimi i Statutit, Rregullores së Punës dhe Rregulloreve të Komunës.
- b) miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- c) miratimin e çështjeve tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin sipas Statutit apo Rregullores së Punës;
- d) kompensimet për anëtarët e Kuvendit;
- e) planin dhe raportin vjetor të punës;
- f) themelimin e Komisioneve - Komiteteve të Kuvendit;
- g) zgjedhjen e Kryesuesit dhe Zëvendës kryesuesi për komunitete;
- h) lartësinë e tarifave, ngarkesave dhe gjobave komunale;
- i) krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit;
- j) emërimin dhe riemërimin e rrugëve dhe vendeve tjera publike
- k) arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale, marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të Komunave të Republikës së Kosovës;
- l) miratimin e planit të përgjithshëm strategjik;
- m) planin e zhvillimit ekonomik të Komunës;
- n) planin rregullues urban dhe ndryshimin e tij;
- o) themelimin dhe menaxhimin e ndërmarrjeve komunale;
- p) mbykqyr organet ekzekutive dhe shërbimin civil që të veprojnë në përputhje me ligjet.
- q) çështje tjera që kërkohen me Ligj.

#### **KAPITULLI I -II - KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS**

##### **Neni 35**

**35.1** Kuvendi i Komunës zgjedh Kryesuesin e Kuvendit të Komunës nga radhët e anëtarëve me mandat të njëjtë sikurse, anëtarët e kuvendit të komunës. Propozim lista për kryesues të

kuvendit të komunës duhet të ketë së paku dy (2) kandidatë të mundshëm për t`u zgjedhur kryesues i kuvendit të komunës.

**35.2** Votimi për kryesues të kuvendit të komunës është me vota të fshehta, për t`u zgjedhur në votimin e parë kandidati i propozuar kryesues i kuvendit duhet të marrë më shumë se gjysma e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur.

**35.3** Në rast se në votimin e parë asnjëri prej kandidateve nuk e siguron shumicën e kërkuar atëherë dy kandidatet me numrin më të madh të votave shkojnë në votimin e dytë. Kandidati që merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur do të zgjidhet kryesues i kuvendit të komunës.

### **Neni 36**

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës i thërret dhe i kryeson mbledhjet e Kuvendit të Komunës. Në mungesë të kryesuesit të Kuvendit, mbledhjet i thërret dhe i kryeson zëvendës kryesuesi i Komuniteteve.

### **Neni 37**

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës mund të thirren edhe nga 1/3 e anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe nga Komitetet e Kuvendit të Komunës, në bazë të Rregullave dhe procedurave ligjore.

### **Neni 38**

**38.1** Posti i Zëvendës kryesuesit të Kuvendit të Komunës caktohet nga radha e komuniteteve që përbëjnë mbi 10% të popullsisë së Shtërpcës, sipas procedurave të parapara me Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe Rregulloren e punës.

**38.2** Postin e Zëvendës kryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete e mban kandidati përfaqësues i popullatës jo shumicë, që ka marrë më shumë vota në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje në kuvendin e komunës.

### **Neni 39**

#### **Detyrat e zëvendës kryesuesit të Kuvendit të komunës për komunitete**

**39.1** Zëvendës kryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete i komunës promovon dialog ndërkomunal dhe shërben si pikë qendrore zyrtare për adresimin e brengave dhe interesave të komuniteteve jo shumicë në mbledhjet e kuvendit.

**39.2** Zëvendës kryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave të komuniteteve apo pjesëtarëve të tyre, në mënyrë që aktet apo vendimet e kuvendit të komunës të mos i shkelin të drejtat e garantuara kushtetuese të tyre.

**39.3** Zëvendës kryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete, aktet apo vendimet e tilla ia paraqet kuvendit të komunës për rishqyrtim.

- 39.4** Në rast se kuvendi i komunës nuk e shqyrton aktin apo vendimin, ose zëvendëskryesuesi i Kuvendit të komunës konsideron se rezultati, pas rishqyrtimit, ende paraqet shkelje të të drejtave të garantuara kushtetuese, ai mund ta parashtojë çështjen në Gjykatën Kushtetuese e cila mund të vendosë për pranimin e çështjes për shqyrtim.

### **KAPITULLI I -III- KOMITETET E PËRHERSHME**

#### **Neni 40**

Pas konstituimit, Kuvendi i Komunës formon Komitete të përhershme në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe atë:

- a) Komitetin për Politikë dhe Financa dhe
- b) Komitetin për Komunitete

#### **Neni 41**

- 41.1** Komiteti për Politikë dhe Financa kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe përbërja e tij duhet të reflektojë përfaqësimin e etniteteve politike në Kuvendin e Komunës.
- 41.2** Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifrat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor dhe afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe marrjen e raporteve nga Kryetari i Komunës dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

#### **Neni 42**

- 42.1** Komiteti për Komunitete përfshin në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, anëtarët tjerë janë përfaqësuesit e komuniteteve. Çdo komunitet që jeton në komunë përfaqësohet me nga një përfaqësues. Përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë në komunë e përbëjnë shumicën e anëtarëve të Komitetit për Komunitete.
- 42.2** Komiteti për Komunitete është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve të Komunës me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për të siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda Komunës.

### **KAPITULLI I -IV- MBLEDHJET E KUVENDIT TË KOMUNËS DHE KOMITETEVE**

#### **Neni 43**

## Mbledhja inauguruuese

- 43.1** Kuvendi i komunës e mban mbledhjen inauguruuese brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.
- 43.2** Mbledhja inauguruuese e kuvendit të komunës thirret nga kryetari (aty ku është zgjedhur) brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.
- 43.3** Nëse kryetari i Komunës nuk e thërret mbledhjen sipas detyrës në paragrafin 2 të këtij neni, mbledhja inauguruuese e kuvendit të komunës mund të thirret nga anëtari më i vjetër i zgjedhur i kuvendit komunal, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data kur kryetari është dashur të thirr mbledhjen inauguruuese të kuvendit të komunës.
- 43.4** Nëse anëtari më i vjetër i kuvendit nuk e thërret mbledhjen sipas detyrës së tij në paragrafin 3 të këtij neni, mbledhja inauguruuese e kuvendit të komunës mund të caktohet me iniciativë të shumicës së anëtarëve të zgjedhur të kuvendit të komunës.
- 43.5** Kuvendi komunal duhet të mbajë së paku dhjetë mbledhje në vit pesë nga të cilat duhet të mbahen gjatë gjashtë muajve të parë.
- 43.6** Në mbledhjet e para të çdo viti fiskal, kuvendi komunal dhe çdo komitet i tij përcaktojnë datat për mbledhjet e rregullta që duhet të mbahen gjatë viti. Kalendari për të gjitha mbledhjet mund të ndryshojë me një vendim të posaçëm të anëtarëve të kuvendit dhe komitetit. Mbledhjet e tjera mund të thirren në çdo kohë.

### Neni 44

Të gjitha takimet duhet të thirren dhe mbahen në pajtim me Rregulloren e Punës. Personi i cili thërret apo i udhëheq takimet duhet të sigurojë që të gjithë anëtarët që marrin pjesë në mbledhje të kenë të drejta të njëjta dhe të barabarta si dhe të kenë mundësi të marrin pjesë në të gjitha veprimet.

### Neni 45

- 45.1** Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të Kuvendit të Komunës janë të hapura për publikun, përfaqësuesit e mjeteve të informimit dhe subjekteve të interesuara kur ndonjë çështje që është e ndërlidhur me to është objekt diskutimi, përveç në rastet që parashihen ndryshe me legjislacionin në fuqi.
- 45.2** Kuvendi i Komunës nëpërmjet Zyrës për Informim njofton publikun të paktën 7 ditë para mbledhjeve të rregullta dhe 3 ditë para mbledhjeve të jashtëzakonshme me mjetet e mëposhtme:
- a) shpallja publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të Komunës;
  - b) mediet e shkruara dhe elektronike lokale dhe
  - c) faqen zyrtare te internetit të Kuvendit të Komunës.
- 45.3** Njoftimi publik duhet të përmbajë:
- a) datën e mbledhjes;
  - b) kohën e mbledhjes;



- c) vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe
- d) rendin e ditës.

**45.4** Komitetet nëpërmjet Zyrës për Informim njoftojnë publikun 3 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjes. Njoftimi publik përmban:

- a) datën e mbledhjes;
- b) kohën e mbledhjes;
- c) vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe
- d) rendin e ditës.

#### **Neni 46**

Çdo anëtarë i publikut i cili merr pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të tij, me lejen e Kryesuesit të takimit, mund të bëjë pyetje dhe mund t'i drejtohet mbledhjes. Rregullorja e Punës rregullon të drejtat dhe veprimet e Kryesuesit të mbledhjes gjatë ushtrimit të detyrës së tij.

#### **Neni 47**

- 47.1** Të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të emërohen nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Anëtarësimi në çdo rast duhet të pasqyrojë në mënyrë sa më të përafërt proporcionin e nivelit të përfaqësimit të partive politike dhe përfaqësimin gjinor në Kuvendin e Komunës.
- 47.2** Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa nuk kanë të drejtë të jenë edhe anëtarë të Komiteteve tjera obligative.
- 47.3** Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa kryesohen nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës në mungesë të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, mbledhjet kryesohen nga njëri prej anëtarëve të Komitetit.
- 47.4** Numri i anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa përbëhet prej 7 (shtatë) anëtarëve.

#### **Neni 48**

- 48.1** Anëtarët e Komitetit për Komunitete emërohen nga Kuvendi i Komunës nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe përfaqësuesve të komuniteteve pakicë.
- 48.2** Komiteti për Komunitete në Komunë përbëhet nga përfaqësuesit e secilit komunitet pakicë që jeton në komunë, shumica e anëtarëve të këtij komiteti përbëhet nga komunitetet pakicë.
- 48.3** Numri i anëtarëve të Komitetit për Komunitete përbëhet prej 7 (shtatë) anëtarëve.

#### **Neni 49**

##### **Komiteti për Kthim**

- 49.1** Kuvendi komunal themelon Komitetin për Kthim që merret me çështjen e kthimit të të gjitha komuniteteve dhe komunikon me organet shtetërore dhe organizatat ndërkombëtare që merren me çështjet e kthimit.

- 49.2 Ky Komitet përbëhet prej pesë anëtarëve që përfaqësojnë të gjitha komunitetet që jetojnë në komunë, shumica e së cilës përfaqësojnë komunitetin serb.
- 49.3 Mandati i këtij komiteti do të jetë për katër vite, nëse ai nuk zgjatet me vendim të kuvendit.

### **Kuorumi Neni 50**

- 50.1 Kuorumi për të gjitha takimet e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të tij, është së paku gjysma e numrit të anëtarëve të Kuvendit të komunës. Kuorumi duhet të verifikohet para çdo vendimi që merr Kuvendi i Komunës.
- 50.2 Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve, të gjithë anëtarët, duke përfshirë edhe kryesuesin e mbledhjes, kanë vetëm një vote, por kryesuesi e ka një vote shtesë në rast të numrit të njëjtë të votave për ose kundër një propozimi.
- 50.3 Kuvendi i Komunës dhe Komitetet marrin vendime me votim të hapur, përveç nëse kërkohet ndryshe me këtë Statut dhe me Rregullore të punës së Kuvendit të Komunës.

### **MBLEDHJET E JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË KOMUNËS Neni 51**

- 51.1 Takimi i jashtëzakonshëm i kuvendit të komunës caktohet nga kryesuesi apo me kërkesë të bërë me shkrim nga, më së paku, një e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit të komunës, apo me kërkesë të kryetarit.
- 51.2 E drejta për të thirrur një takim të jashtëzakonshëm gjithashtu përfshin të drejtën për caktimin e rendit të ditës për takimin e caktuar.
- 51.3 Pikat e caktuara në rendin e ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes.
- 51.4 Takimi i jashtëzakonshëm i kuvendit të komunës nuk mbahet nëse të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës dhe publiku nuk janë njoftuar me shkrim, siç kërkohet me rregulloret e punës, së paku tri (3) ditë pune para datës së mbajtjes së takimit. Detajet përcaktohen në Rregulloren e Punës.
- 51.5 Procedurat e njëjta që kërkohen për njoftimin dhe çështjet e tjera që zbatohen për mbledhjet e rregullta, zbatohen për mbledhjet e jashtëzakonshme gjithashtu.
- 51.6 Procedurat e lartpërmendura nuk zbatohen për takimet që thirren për shkak të rrethanave urgjente.

### **Neni 52 Mbledhjet e Hapura të Kuvendit Komunal**

- 52.1 Takimet e kuvendit të komunës dhe të gjitha komisioneve të tij janë të hapura për opinion. Anëtarëve të publikut u lejohej pjesëmarrja në takime të kuvendit të komunës, ashtu siç është paraparë në Rregulloren e punës.
- 52.2 Kuvendi i komunës, apo komiteti, me votën e shumicës, mund të vendosë për përjashtimin e opinionit nga i tërë takimi, apo nga një pjesë e tij, në rastet kur:

- a) mendohet se mbajtja e një takimi të hapur mund të shpie deri te një çrregullim publik apo dhunë;
- b) takimi i hapur kërcënon të zbulojë informacione (dhe dokumente), të cilat janë të klasifikuara si të besueshme sipas Ligjit mbi çasjen në dokumentet zyrtare;
- c) kërcënon të zbulojë informacione të ndjeshme personale apo komerciale; ose
- d) informacione lidhur me procedurat gjyqësore të tanishme apo të ardhshme.

**53.2** Në rastet e tilla, kuvendi i komunës njofton për vendimin e marrë.

**53.3** Detajet për mbledhjet e hapura të kuvendit komunal rregullohen me rregulloret e punës.

## **KAPITULLI I -VII-**

### **PAGESA DHE KONFLIKTI I INTERESIT TË ANËTARËVE TË KUVENDIT KOMUNAL**

#### **Neni 53**

**53.1** Pagesa për anëtarët e kuvendit komunal dhe anëtarëve të komiteteve për punën që e bëjnë në komunë do të rregullohet me një vendim të posaçëm në kuvendin komunal, në përputhje me rregullat e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

**53.2** Anëtarët e kuvendit komunal nuk mund të caktohen gjithashtu si anëtarë të ekzekutivit të komunës dhe administratës.

#### **Neni 54**

Përjashtimet në procesin e vendim-marrjes për shkak të konflikteve të interesit bëhen në bazë të nenit 38 të Ligjit për Vetëqeverisjen lokale dhe duhet të shënohen në procesverbalin e mbledhjes së Kuvendit të Komunës.

#### **Neni 55**

Anëtarët që kanë konflikt të interesit në lidhje me një çështje të caktuar nuk duhet të flasin e as të votojnë për çështjen për të cilën kanë konflikt të interesit dhe duhet të dalin nga salla e mbledhjes, atëherë kur diskutohet ajo çështje.

#### **Neni 56**

**56.1** Nëse vjen deri te ndonjë konflikt potencial i interesit pasi që është marrë vendimi, por para se të zbatohet ai, vendimi duhet të suspendohet dhe çështja duhet të hetohet.

**56.2** Nëse arrihet në përfundim se ka ekzistuar konflikti i interesit, vendimi duhet të anulohet tërësisht dhe duhet të bëhet një votim i ri për marrjen e vendimit.

## **KAPITULLI I –VIII-**

### **MARRËDHËNIE NDËRKOMUNALE DHE PARTNERITETI**

#### **Neni 57**

- 57.1** Kryetari i Komunës pas konsultimeve me Komitetin për Politikë dhe Financa duhet të prezantojë rekomandimet për Kuvendin e Komunës për marrëveshjet të cilat mund të jenë të nevojshme në bazë të nenit 28 dhe 29 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.
- 57.2** Kuvendi i Komunës vendosë për lidhjen e marrëveshjeve ndërmjet komunave për ushtrimin e përgjegjësisë dhe pushtetit në bashkëpunim me njëra tjetrën.

### **Neni 58**

Kryetari i komunës, pas konsultimeve që bënë me Komitetin për Politikë dhe Financa, prezanton rekomandimet e tij në kuvendin komunal për marrëveshje të cilat ndërlidhen në menaxhimin e ‘kompanive komunale’ për mbikëqyrje të shërbimeve të përbashkëta që ofrohen në një a më shumë komuna.

### **Neni 59** **Auditimi**

- 59.1** Komuna ka obligim që se paku një (1) herë në vit të bëjë auditim të brendshëm në pajtim me ligjin.
- 59.2** Të gjitha raportet e auditorit dhe përgjegjësitë e autoriteteve të Komunës janë publike.

### **Neni 60** **Pasuria e komunës**

- 60.1** Komuna ka të drejtë të posedojë dhe menaxhojë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme
- 60.2** Komunat kanë ka të drejtë të shesin dhe japin me qira pasurinë sipas ligjit, me përjashtim të shitjes së tokës e cila rregullohet me ligj të posaçëm.
- 60.3** Komuna mban dhe udhëheq regjistrin e pronës së luajtshme dhe të paluajtshme.
- 60.4** Kryetari i komunës emëron komisione (ad hoc) me qëllim të regjistrimit të pasurisë së komunës më së voni një (1) muaj para përfundimit të vitit fiskal.
- 60.5** Të drejtën për ta emëruar komisionin për regjistrimin e pasurisë Kryetari mund ta delegojë në drejtorinë e financave.

### **Neni 61**

Kuvendi i Komunës brenda kornizës së ligjit mund të bëjë marrëveshje që të bashkëpunoj dhe të formoj partneritete me kuvendet tjera komunale ashtu që të kryejnë detyrat që janë në interes të përbashkët.

### **Neni 62**

Kuvendi i Komunës mund të bashkohet me kuvendet tjera komunale në asociacione për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të përbashkëta.

### **Neni 63** **KAPITULLI I -IX-**

## **FINANCAT KOMUNALE DHE PROCEDUARAT BUXHETORE**

- 63.1** Komuna ka buxhetin dhe financat e saja për të ushtruar kompetencat e saja të cilat rregullohen me Ligjin mbi Financat lokale dhe Rregulloren Komunale mbi procedurat Financiare.
- 63.2** Të gjitha çështjet që janë të lidhura me administrimin financiar të Komunës janë përgjegjësi e Kryetari të Komunës.
- 63.3** Kryetari i Komunës këto përgjegjësi që kanë të bëjnë me administrimin financiar mundë t'i bartë tek Nënkryetari i Komunës apo te ndonjë prej Drejtorëve të Drejtorive Komunale.

## **PJESA E SHTATË**

### **EKZEKUTIVI I KOMUNËS**

#### **KAPITULLI I –VII-**

#### **KRYETARI I KOMUNËS DHE ADMINISTRATA E KOMUNËS**

##### **Neni 64**

Kryetari i Komunës është udhëheqës i Degës Ekzekutive të Komunës.

##### **Neni 65**

Kryetari i Komunës ushtron përgjegjësitë e përcaktuara në nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe përgjegjësitë e përcaktuara me këtë statut.

##### **Neni 66**

**66.1** Përgjegjësitë shtesë të Kryetari të Komunës janë si në vijim:

- a) mbikëqyrë administrimin e përgjithshëm financiar të Komunës;
- b) mbikëqyrë zbatimin e të gjitha akteve juridike të aprovuara nga Kuvendi i Komunës;
- c) delegon përgjegjësi te drejtorët e Drejtorive dhe mbikëqyr zbatimin e përgjegjësive të deleguara;
- d) i propozon Kuvendit të Komunës ndryshime në lidhje me funksionin dhe numrin e Drejtorive dhe funksionet e tyre në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- e) i ofron propozime Kuvendit të Komunës për konstituimin, organizimin dhe koordinimin e organeve komunale si dhe krijimin e institucioneve dhe ndërmarrjeve;
- f) bënë caktimin apo ndarjen dhe koordinimin e përkohshëm të punëve dhe përgjegjësive në mes të drejtorive sipas nevojës, duke pasur për bazë lëmin apo projektin e caktuar;
- g) Propozon Kuvendit të komunës Rregulloret komunale për miratim
- h) dhe përgjegjësi tjera të përcaktuara nga Kuvendi i Komunës.

**66.2** Kryetari i komunës raporton për punën e degës së ekzekutivit çdo tre muaj. Përpos raporteve tremujore, kryetari mund të raportojë përmes zëvendësve të tij/saj apo zyrtarit të caktuar.

### **Neni 67**

- 67.1** Ekzekutivi i Komunës – Kryetari, për të ushtruar përgjegjësitë e përcaktuara me ligj dhe përgjegjësitë e përcaktuara nga Kuvendi i Komunës ndihmohet nga Nënkyetari i Komunës, Nënkyetari i Komunës për Komunitete, Drejtorët e Komunës dhe Administrata e Komunës.
- 67.2** Nënkyetari i Komunës emërohet me mandat të njëjtë nga Kryetari dhe shkarkohet prej tij.
- 67.3** Nënkyetari i Komunës për Komunitete propozohet nga Kryetari i Komunës dhe emërohet prej Kuvendit të Komunës.
- 67.4** Procedurat për emërimin dhe shkarkimin e nënkyetarit për komunitete bëhet në pajtim me nenin 61.3 të LVL.
- 67.5** Nënkyetari i për komunitete ndihmon kryetarin dhe i ofron atij këshilla dhe udhëzime për çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet jo shumicë.

### **Neni 68**

Administrata e Komunës organizohet në Drejtori. Çdo Drejtori e Komunës menaxhohet nga Drejtori. Drejtorët emërohen dhe shkarkohen nga Kryetari i Komunës.

### **Neni 69**

**69.1** Në bazë të këtij Statuti, Komuna e Shtërpcës do t'i ketë këto Drejtori:

1. Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme
2. Drejtorinë për Buxhet dhe Financa;
3. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, turizëm, bujqësi dhe pylltari
4. Drejtoria për Planifikim, Rindërtim, Urbanizëm dhe mbrojtje të ambientit
5. Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
6. Drejtorinë e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit
7. Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
8. Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit;

**69.2** Organizimi i brendshëm i Drejtorive dhe sistemimi i Shërbyesve Civil në vende të punës do të bëhet në bazë të “Rregullores” për organizimin dhe sistemimin e vendeve të punës.

### **Neni 70**

#### **Drejtori i Administratës së Përgjithshme**

Kjo drejtori është përgjegjëse për:

- 70.1** Të ndihmuar dhe përcjell procedurat për aprovimin e Rregulloreve të Komunës si dhe përpunime tekniko ligjor të tyre që iniciohen nga Drejtoritë e Komunës, Komitetet dhe Kuvendi i Komunës përmes Zyrës Ligjore.
- 70.2** udhëheq me shërbimin e gjendjes civile në Komunë;
- 70.3** mban regjistrat për gjendjen civile;
- 70.4** është përgjegjëse për mbarëvajtjen e punës në zyrën pritëse; (është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e shërbimeve të përbashkëta: sigurimin, pastrimin dhe mirëmbajtjen e objektit/eve të Komunës;
- 70.5** mban evidencë për pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të Komunës
- 70.6** kryen edhe punë tjera të caktuara nga Kryetari i Komunës dhe Kuvendi.

### **Neni 71**

#### **Drejtoria për Buxhet dhe Financa**

Kjo Drejtori është përgjegjëse për:

- a) hartimin e Rregulloreve të Komunës për çështjet financiare;
- b) ndihmon Kryetarin e Komunës në përgatitjen e projekt-buxhetit;
- c) është përgjegjëse për mbajtjen e llogarive dhe raporteve financiare vjetore;
- d) është përgjegjëse për menaxhimin e thesarit nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës;
- e) është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e sistemeve dhe procedurave për ekzekutimin e buxhetit;
- f) përgatit procedurat dhe raportet e kontabilitetit;
- g) jep këshilla profesionale nga fusha e buxhetit organeve të Komunës;
- h) kryen edhe punë tjera të caktuara nga Kryetari i Komunës dhe Kuvendi;

### **Neni 72**

#### **Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Turizëm, Bujqësi dhe Pylltari**

Kjo Drejtori është përgjegjëse që të:

- a) organizon dhe udhëheq punën e tërësishme në drejtori
- b) koordinon dhe mbikëqyr punën e sektorit dhe shërbimeve-këshillimeve
- c) mbikëqyr dhe koordinon punët në sektorin e veterinars
- d) harton plane zhvillimore për bujqësi, pylltari
- e) propozon masa për favorizimin dhe mbrojtjen e prodhuesve bujqësor
- f) organizon trajnime nga lëmi i bujqësisë
- g) propozon buxhetin për nevoja të drejtori
- h) plan programin për të mbjellurat e kulturave bujqësore
- i) plan programin për korrje-shirje dhe vjeljen e prodhimeve bujqësore
- j) kërkon certifikata për prodhimet bujqësore
- k) merr pjesë në të gjitha komisionet që kanë të bëjnë me bujqësi

- l) pranon raportet nga rojet e pyllit
- m) pranon dhe evidenton të gjitha shkresat e parashtruara nga palët.
- n) zhvillimin e politikave menaxhuese me kafshë të egra dhe ekoturizëm.
- o) mbikëqyrë implementimin e planeve menaxhuese të Pylltarisë gjuetisë, ekoturizmit dhe resurseve tjera natyrore.
- p) përgatitë dhe propozon projekte nga fushat e ndryshme të pylltarisë gjuetisë dhe ekoturizmit.
- q) inicion projekte dhe programe që do të mbështesin përmirësimin e kushteve të jetës, punësimin si dhe zhvillimin e resurseve njerëzore të popullatës rurale.
- r) promovon dhe mbështete krijimin dhe vazhdimin e aktiviteteve në fermë dhe jashtë fermës dhe punon në drejtimin të promovimit të mundësive për gjenerimin e të ardhurave rurale (punësimin)
- s) kryen edhe punë tjera të parapara me ligj dhe të caktuar nga ana e Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit
- t) harton planin për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të Komunës;
- u) harton plane konkrete për zhvillimin e industrisë zeytare;
- v) harton planin për shfrytëzimin e burimeve ekonomike që janë brenda Komunës;
- w) krijon kushte të qëndrueshme për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;

### **Neni 73**

#### **Drejtoria për Planifikim, Rindërtim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të ambientit**

Kjo Drejtori është përgjegjëse për:

- a) hartimin e planit zhvillimor të Komunës;
- b) hartimin e planit të zhvillimor, urbanistik dhe rural të Komunës;
- c) harton kriteret për dhënien e lejeve të ndërtimit
- d) harton Rregullore Lokale për kontrollimin e mbeturinave dhe hedhurinave brenda territorit të Komunës;
- e) kujdeset për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit;
- f) kujdeset për trajtimin e ujërave të zeza dhe mbeturinave të ngurta dhe
- g) punë tjera të caktuara nga Kryetari i Komunës dhe Kuvendi.

### **Neni 74**

#### **Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë**

- a) kryen punë të ndërlikuara gjeodeto-teknike nga lëmia e punëve themelore;
- b) merr pjesë në punët e përtëritjes ose plotësimit të rrjetave ekzistuese të bazave gjeodete si dhe në punët e vendosjes dhe të përcaktimit të ri;
- c) kryen bartjen e rregullacioneve të projektuara në terren;
- d) kryen matjen dhe përpunimin e shënimeve të matjes si dhe llogaritjen e koordinatave dhe të kushteve të bazës gjeodete;



- e) kryen punët e matjes dhe të identifikimit të ngastrave sipas kërkesave dhe nevojës së komunës;
- f) benë kërkesën për bartje të ndryshimeve në operat kadastral;
- g) kryen incizime të ndryshme dhe harton plane situacionale për nevojat e drejtorisë dhe të Komunës në përgjithësi;
- h) kryen vendosjen e shënimeve të caktuara në regjistrin e paraqitjeve;
- i) rregullon dhe regjistron shënimet origjinale të kaheve dhe të objekteve nëntokësore të cilat i merr kjo organizatë dhe bashkësi të cilave kahet dhe objektet u janë besuar për shfrytëzim;
- j) i krahason shënimet e fituara me gjendjen reale në terren dhe rilevim ose me identifikim;
- k) kryen të gjitha punët nga përgjegjësia e drejtorisë;
- l) harton materialin e nevojshëm për Këshillin e Drejtorëve, Komitetin për pronë, Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin e Komunës;
- m) kujdeset për ekzekutimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës;
- n) zhvillon procedurë administrative lidhur me kërkesat e palëve;
- o) pranon paraqitjet për eksproprijim dhe deeksproprijim të tokës në pronësi të komunës i regjistron dhe i përcjellë në evidencë përkatëse;
- p) zhvillon procedurën e eksproprijimit dhe deeksproprijimit;
- q) udhëzon palën se nëse nuk është i kënaqur me Vendim mund të ushtrojë ankesë Agjensionit Kadastral të Kosovës;
- r) harton kriteret për dhënien me qira të objekteve të Komunës dhe tokës ndërtimore të Komunës;
- s) mban evidencën për emërtimet e vendbanimeve, rrugëve, shesheve si dhe numrat e objekteve dhe shtëpive, brenda territorit të Komunës;
- t) bën vlerësimin e pronës sipas kriterëve dhe standardeve të caktuara me legjislacionin në fuqi;
- u) mban regjistrin e pronës së paluajtshme dhe regjistrin e tokës së Komunës;
- v) bënë azhurnimin e pronës në bazë të dokumenteve të verifikuara;
- w) mbron pronën e Komunës nga uzurpimet e ndryshme;
- x) mbanë evidencë për punën e bërë;
- y) bashkëpunon ngushtë me zyrën e përfaqësimeve të komunës;

## **Neni 75**

### **Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport**

Kjo Drejtori është përgjegjëse për:

- a) planifikon zhvillimin e arsimit lokal dhe aftësimin e personelit mësimor, në bashkëpunim të ngushtë me MASHT;
- b) nxit bashkëpunimin midis personelit arsimor në raport me nxënësit dhe prindërit;

- c) siguron mirëmbajtjen dhe riparimin e objekteve shkollore dhe objekteve tjera përcjellëse me fondet publike të siguruara;
- d) nxjerr rregulla disiplinore për sjelljen dhe disiplinën e nxënësve në çdo institucion arsimor;
- e) merr pjesë në përzgjedhjen e drejtorëve dhe mësuesve të shkollave;
- f) menaxhon në mënyrë të drejtë me të gjitha objektet komunale të kulturës sportit dhe rinisë;
- g) organizon takime me rëndësi kulturore, sportive dhe të rinisë për Komunën;
- h) organizon debate për zhvillimin e kulturës, sportit dhe rinisë në Komunë;
- i) mban shënime për të arriturat kulturore, sportive dhe rinore në Komunë;
- j) zhvillon planin për mbështetjen e aktiviteteve kulturore, sportive dhe rinore; dhe
- k) punë tjera të caktuara nga Kryetari i Komunës dhe Kuvendi.

### **Neni 76**

#### **Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale**

Kjo Drejtori është përgjegjëse për:

- a) ofrimin e kujdesit primar shëndetësor në Komunë, në pajtim me dispozitat ligjore;
- b) inspektimin e qendrave private të përkujdesit primar shëndetësor;
- c) vlerësimin e nevojave lokale për shëndetësi primare;
- d) vendosjen e objektivave lokale për kujdesin primar shëndetësor;
- e) zhvillimin e buxhetit bazuar në nevojat lokale dhe duke respektuar udhëzimet e MSH;
- f) koordinon dhe mbikëqyr punën e QKMF-së dhe Ambulancave;
- g) operimin e qendrave për punë sociale dhe qendrave për mirëqenie sociale;
- h) zhvillimin e planit strehimor për territorin e Komunës;
- i) sigurimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit, sipas standardeve të përcaktuara nga MPMS; dhe
- j) punë tjera të caktuara nga Kryetari i Komunës dhe Kuvendi.

### **Neni 77**

#### **Drejtoria për Shërbime Publike, mbrojtjes dhe shpëtim.**

Kjo Drejtori është përgjegjëse për:

- a) përcaktimin dhe ofrimin e shërbimeve publike lokale dhe të infrastrukturës duke përfshirë furnizimin me ujë, ujësjellësin dhe kanalizimin, përpunimin e ujërave të zeza, mirëmbajtjen e rrugëve lokale, transportin lokal dhe planet për ngrohtore lokale.
- b) sigurimin dhe mirëmbajtjen e parqeve publike hapësirave të hapura dhe varrezave;
- c) lëshimin e lejeve për shërbime dhe pajisje duke përfshirë transportin lokal publik dhe shërbimin e taksistëve.
- d) mirëmbajtjen dhe kontrollimin e tregut të gjelbër dhe tregut të kafshëve.

- e) mirëmbajtjen e ndriçimit publik, reklamat ndriçuese të firmave.
- f) mbikëqyr dhe siguron zbatimin e Ligjit për Pronën Publike të Komunës dhe merr masa adekuate për mbrojtjen e tyre dhe (te konsultohet me kadastrin)
- g) hartimin e Planit të Komunës për Mbrojtje dhe Shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera.
- h) vlerësimin e rrezikshmërisë, duke u bazuar në të dhënat faktike për planifikim, ndërmerr masat parandaluese, për pengimin, zvogëlimin dhe eliminimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
- i) sigurimin dhe mirëmbajtjen e rezervave të mjeteve materiale për rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.
- j) organizimin e sistemit të vështrimit, lajmërimit dhe alarmimit, strehimin e popullsisë në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.
- k) bashkëpunon me organet e sigurisë dhe subjektet tjera nga kjo lëmi.
- l) mbikëqyr objektin e Kuvendit të Komunës dhe angazhon personelin për sigurimin e objekteve komunale.
- m) hartimin e Planit të Mbrojtjes nga Zjarri për territorin e Komunës dhe organizimin e mbrojtjes nga zjarri.
- n) kryen edhe punë tjera të parapara me ligj dhe të caktuara nga Kryetari i Komunës dhe Kuvendi.

#### **Neni 78**

#### **Zyra për Komunitete dhe Kthim**

Kjo zyre është përgjegjëse për:

- a) përfaqësimin e interesave të komuniteteve dhe kthimin e të zhvendosurve në komunën e Shtërpcës në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi.
- b) bashkëpunon me ministritë, organizatat vendore dhe ndërkombëtare për çështje të komuniteteve dhe kthimit.

#### **Neni 79**

#### **Takimet e kryetarit me drejtorë**

Kryetari i komunës takimet me drejtorët e drejtorive mund t'i organizojë veç e veç me çdo drejtor ose në formë të organizimit si kolegjum me të cilët konsultohet për çështjet në kompetencat e komunës dhe të çdo drejtori veç e veç.

## **PJESA E TETË**

### **KAPITULLI I -VIII-**

### **SHËRBIMI CIVIL I KOMUNËS**

## **Neni 80**

Shërbimi Civil i Komunës udhëhiqet në bazë të parimeve dhe procedurave të përcaktuar me legjislacionin në fuqi. Me rastin e rekrutimit të personelit të komunës duhet respektuar procedurat e hapura dhe konkurruese për të pranuar shërbyes civil të komunës me kualitet të lartë, në bazë të meritave dhe kompetencave.

## **Neni 81**

Administrata e Komunës ka udhëheqësin e personelit, i cili rekrutohet nga Kryetari i Komunës, në pajtim me rregullat dhe procedurat ligjore të shërbimit civil në Republikën e Kosovës.

## **Neni 82**

Punësimi në shërbimin civil të komunës duhet të mbikëqyret dhe rregullohet nga udhëheqësi i personelit për të siguruar që shërbimi civil reflekton proporcion të drejtë profesional, gjinorë, etnik dhe përfaqësimit të personave me aftësi të kufizuar

## **Neni 83**

Kryetari i Komunës në bashkëpunim me udhëheqësin e Personelit do të emërojë një nën-komision detyrat e të cilit do të jenë këshillimi dhe konsultimi në përgjithësi për çështjet e resurseve njerëzore që kanë të bëjnë me shërbimin civil komunal në veçanti me çështjet në vijim:

- a) kategoritë dhe numrat për kategori
- b) mbikëqyrja dhe përgjegjësitë
- c) detyrat dhe obligimet
- d) delegimi i detyrave dhe obligimeve
- e) rekrutimi dhe përzgjedhja
- f) kushtet e pranimit
- g) fillimi i punës në zyrë, puna provuese
- h) procedurat ankimore
- i) procedurat e kundërshtimeve
- j) trajnimi dhe provimet
- k) rishqyrtimi i paraqitjes dhe procedurat e vlerësimit
- l) përparimi dhe sukcesi në karrierë
- m) dosjet dhe referencat e stafit
- n) kohëzgjatja e punësimit dhe njoftimi mbi pushimin e marrëdhënies së punësimit
- o) pagesat dhe shpërblimet tjera
- p) pagesa për udhëtim dhe mëditjet
- q) pushimi
- r) rregullat e shërbimit civil komunal

## **Neni 84**

## **Ankesat e qytetarëve**

Çdo qytetarë mund të parashtrojë ankesë në afatin ligjor nda vendimit administrativ të organeve të komunës, nëse ai apo ajo mendon se i janë cenuar të drejtat e tij ose të saj. Shqyrtimi i ankesave bëhet në pajtim me ligjin për procedurën administrative

### **Neni 85 Raporti vjetor**

Kryetari i komunës në konsultim me Komitetin për Politik dhe Financa, duhet të sigurohet që raporti vjetor t`i paraqitet Kuvendit të Komunës ashtu siç kërkohet ne ligj.

### **Neni 86**

- 87.1** Kryetari i Komunës bënë propozimin e buxheti për komitetin për politikë dhe financa dhe më pastaj i dërgohet kuvendit komunal për aprovim.
- 87.2** Viti fiskal i Komunës fillon me 1 Janar, Kryetari i Komunës i dorëzon Kuvendit të Komunës buxhetin Komunal për miratim sa më shpejtë që është e mundur pas njoftimit për lartasin e fundit të ndarë për vitin vijuese

## **PJESA E NËNTË KAPITULLI I -IX- DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 87**

Në rastet kur ekziston ndonjë konflikt midis dispozitave statutare me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, mbizotërojnë dispozitat e Ligjit.

### **Neni 88**

Ky statut hynë në fuqi pas aprovimit nga Kuvendi i Komunës, nënshkrimit të tij nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe certifikimit nga autoriteti mbikëqyrës në kuptim të nenit 81 të LVL-së.

### **Neni 89**

Pas hyrjes në fuqi të këtij statuti pushojnë të vlejnë të gjitha dispozitat e Statutit nr 74/01 të miratuar me datën 13.02.2004 dhe aktet komunale të mëparshme në ato pjesë ku janë në kundërshtim me statutin e Komunës.

### **Neni 90**

Me aprovimin e këtij statuti të gjitha aktet tjera të komunës brenda gjashtë muajve do të harmonizohen me statutin në fuqi.

### **Neni 91**

Interpretimi autentik i këtij Statuti bëhet nga Kuvendi i Komunës.

## **Neni 92**

### **Amandamenti i këtij Statuti**

**90.1** Iniciativa për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit Komunal mund të merret nga:

- a) Kryetari i komunës
- b) Një e treta e anëtarëve të kuvendit komunal
- c) Me iniciativën e 15% të qytetarëve me të drejtë vote në komunë.

**90.2** propozimi për të ndryshuar Statutin i dorëzohet kryesuesit të Kuvendit komunal për shqyrtim fillestar. Kuvendi komunal, pas shqyrtimit fillestar, konsulton publikun lidhur me propozimin në fjalë.

**90.3** pas përfundimit të konsultimeve, kuvendi komunal vendos nëse do të ndryshojë Statutin, pas shqyrtimit të të gjitha vërejtjeve të pranuar.

**90.4** çdo propozim për ndryshimin e këtij Statuti do të miratohet nga kuvendi komunal me 2/3 e votave të anëtarëve të kuvendit.

**90.5** procedurat lidhur me ndryshimin e rregulloreve komunale bëhen në pajtim me nenin 12.4 të Ligjit për vetëqeverisje Lokale dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit komunal.

## **KUVENDI I KOMUNËS SË SHTËRPECËS**

**NR.01/898 DATA 14/07/2010.**

**KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS**  
**Dr. Dejan Mrdjinac**

---